



Data:

06 - 07 - 2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:012045

Datë: 16.05.2018

Numri i dokumentit: 00048990

P.nr.3315/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtaren Hakile Ilazi dhe zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga numri 275 paragrai 2 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.2491-6/2017 e datës 28.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 20.04.2018, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me ditën 16.05.2018, përpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] gjendjes se mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datën 10 nëntor 2017, rrëth orës 18,15 h ,në rrugën “Brahim Ademi”, në Ferizaj, me rastin e ndaljes dhe kontrollit nga ana e zyrtarëve policorë të automjetit të markës Rover me targa të regjistrimit [REDAKTUE], është konstatuar se i pandehuri pa autorizim posedonte substancë narkotike të llojit marijuanë, substance kjo e shpallur me ligj si narkotik, e cila i sekuestrohet nga ana e zyrtarëve policorë e që me rastin e ekspertimit është konstatuar se e njëjta substancë është e llojit kanabis-marijuanë që përmbanë Tetrahifrokanabinol (THC) me peshë prej 2,25 gram.

Me çka ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga nen 275 par.2 të KPRK-së,

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPPK-ës, i

SHQIPTON

DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 250/dyqind e pesëdhjetë euro/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nëse dënim i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj nga një ditë burgimi.

Konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca e llojit kanabis – marijuanë që përmbanë Tetrahifrokanabinol (THC) me peshë prej 2,25 gram.

I pandehuri [REDAKTUE] obligohet që në emër të pashallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 25 euro, si dhe në emër të kompensimit e Viktimate të Krimtit shumën prej 30 € (tridhjetë/euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën të evidentuar si PP.II.nr.2491-6/2017 e datës 28.12.2017 ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUE] për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrai 2 i KPRK-së,

Gjykata pasi që studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja konkrete juridiko penale është në juridikcionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të procedohet përpara kësaj gjykate dhe është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale, në bazë të nenit 245, të KPPK-së, mbajti shqyrtimin fillestar më datën 20.04.2018, në të cilën përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Avdullah Abedini lexoi aktin akuzues dhe deklaroi se qëndron në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet dënim i paraparë me ligj.

Gjyqtarja pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246, paragrafi 4, të KPPK-së, të pandehurit i ofroi mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari [REDAKTUE], në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.e cila i vihet në barrë.

Gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të KPPK-së, meqë i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat e kësaj çështje penale siç janë: Raporti i policit, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 10.11. 2017, fotografitë e të pandehurit si dhe dëshmisë së sekuastruar si provë materiale dhe raporti i ekspertizës dhe seakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, andaj shqyrtimi fillestar konform nenit 248 par.4, të KPPK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i ngarkohet me aktakuzë, e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248, paragrafi 1, të KPPK-së, gjyqtarja konform nenit 248, paragrafi 4, të KPPK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, ku është paraparë se nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestare pranon fajësinë dhe gjyqtari individual vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin, mund të vazhdoj menjëherë me shqiptimin e dënimit pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor.

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së. e cila i vihet në barrë, si në datën, kohën dhe vendin siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75, të KPRK-së, dhe si rrrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korekte, pendimin e tije, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, nuk do ta përdorë dhe nuk do të posedoj në të ardhmen materie të tilla, është hera e parë që bie ndesh me ligjin për vepra të tilla penale si dhe lut gjykatën që të i shqiptoj një dënim sa më të butë dhe në mungesë të rrrethanave rënduese gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marr parasysh tërësinë e këtyre rrrethanave të veprës penale, të pandehurit i shqiptoj dënimin me gjobë në shumë prej 250/dyqind e pesëdhjetë euro/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë, me bindjen se dënim i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41` të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.


Numri i lëndës: 2018:012045
Datë: 16.05.2018
Numri i dokumentit: 00048990

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimtit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimtit.

Andaj nga të cekurat më lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.3315/2017, më datë 16.05.2018

Zyrtarja Ligjore
Ganimete Avdiu

Gjyqtarja
Hakile Ilazi


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nëpërmjet kësaj gjykate.